



Kosovo Educational Research Journal

Volume 3, Issue 1, 2-17.

ISSN: 2710-0871

<https://kerjournal.com/>**Puna individuale me fëmijët me nevoja të veçanta**

Shemsi MORINA*

Lulzim IBRI

Esen Spahi KOVAÇ

University of Prizren

University of Prizren

University of Prizren

Abstrakt: Periudha e pasluftës në vendin tonë karakterizohet me ndryshime në të gjitha fushat, përfshirë edhe reformat në sistemin arsimor, me qëllim të përafrimit të sistemit tonë arsimor me sistemin arsimor të Bolonjës. Këto ndryshime përveç mënyrës së organizimit të mësimdhënies, të cilat kishin si qëllim vënien e nxënësit në qendër të vëmendjes, u fokusuan edhe krijimin e kushteve për gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta, Për të përmbushur me sukses këtë synim, institucionet përkatëse në radhe të parë krijuan bazën ligjore, përmirësuan infrastrukturën në shkolla me qëllim të krijimit të mundësive të barabarta, përfshirë edhe fëmijët me NV, u organizuan trajnime për gjithëpërfshirjen, u përgatiten doracak e materiale tjera suplementare për punë me fëmijët me NV, por një rëndësi e veçantë ju kushtua formave të punës si dhe Planifikimit Individual Edukativ, i cili konsiderohet edhe si çelës i suksesit në punën edukative e arsimore me femijët me NV. Punimi me titull Puna individuale me fëmijët me nevoja të veçanta, në vazhdim do trajtoj aspektet teorike e praktike të formave të punës si dhe rëndësisë së planit individual arsimor në punë me fëmijët me nevoja të veçanta.

Fjalët kyçe: Formë individuale e punës, plan individual arsimor, diferencim, të nxënë cilësor.

To cite this article: Morina, Sh., Ibri, L. & Kovaç, E. (2022). **Puna individuale me fëmijët me nevoja të veçanta**. Kosovo Educational Research Journal, 3(1). 2-17.

1. EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS, DOMOSDOSHMËRI E KOHËS SONË

Në shoqëritë përkatësisht kulturat e ndryshme, qasja ndaj personave me nevoja të veçanta, është e llojllojshme. Ajo ndryshon, konform nivelit të zhvillimit të kulturës të një shoqërie konkrete. Në kulturat më të përparuara qasja është diç më e favorshme, në krahasim më atë që ndodh në kulturat provinciale e të prapambetura. Personat me aftësi të kufizuara janë të vetëdijshëm se në kulturat provinciale dinjiteti i tyre është i nëpërkëmbur. Në disa kultura, fëmijët me aftësi të kufizuara i

konsiderojnë si turp apo si dënim i Zotit. Prandaj, përballja me stereotipe të tilla, jeta u bëhet më e vështirë nga sa mendojmë ne, prandaj përkrahja, trajtimi dhe qasja duhet të jetë më e mire, se sa që është realisht.

Në kuptimin më të thjeshtë të fjalës: me nevoja të veçanta nënkuptojmë atë që, një person në kushte të rregullta normale do të duhej të bënte pa vështirësi, ndërsa personi me nevoja të veçanta nuk mund ta bëjë, ose nëse e bënë, e bënë me vështirësi, në krahasim me bashkëmoshatarët e tij. Personat me nevoja të veçanta në realitet mund të kenë një paaftësi, ose ndonjëherë nga shqisat të dëmtuar apo të dobësuar, siç janë: vështirësitë zhvillimore, vështirësi apo dëmtimet në dëgjim, në të folur, në të parë, vështirësi fizike, vështirësi emocionale, në sjellje apo vështirësi intelektuale etj.

Qasja ndaj fëmijëve me NV duhet të jetë specifike e profesionale, siç është qasja shumë-dimensionale, shumë-strukturore, shumë nivelore. Kurrikuli duhet të jetë i përpiluar në atë mënyrë që të ngërthejë në vete: mundësitë, nevojat, kërkesat dhe potencialin akceptues të tyre. Në fakt, kurrikuli duhet të jetë fleksibil, inkluziv, i përshtatur, i modifikuar, i dizajnuar, i adaptuar dhe i kompletuar me trajtim metodologjik, strategjik dhe i plotësuar me teknika të veçanta. Qasja ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, duhet të jetë e njëjtë sikurse me të gjithë fëmijët e tjerë, duke ju përshtatur nevojave specifike të secilit fëmijë. Ata nuk dallojnë, për sa i përket dëshirës, dashurisë, nevojave, kërkesave, dëshirës dhe nevojës për lojë, për të mësuar, për t'u vlerësuar, për t'u çmuar dhe për t'u respektuar, dhe pikërisht për këtë arsye është ligjore, edukative, arsimore e etike, që shoqëria e jonë të përkujdeset në mënyrë të barabartë për të gjithë grupet e fëmijëve pa dallim. Andaj në këtë kontekst objektiv i shkollës së reformuar, ndër të tjera është ndryshimi që ka të bëjë me mësimdhënien, proces i cili duhet të jetë në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta. Është me rëndësi të sigurohen lidhje interaaksionale ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësit, në grupe të mëdha e të vogla, e në veçanti punë e diferencuar me fëmijët me nevoja të veçanta. Me këtë do të jetësohej si dhe kultivohej fleksibiliteti, origjinaliteti, hapja, krijimtaria, menaxhimi, nismat, dialogu, komunikimi, partneriteti etj. Nga këto kuptojmë se mësimdhënësi, në formën e re të mësimdhënies do të gjendet në një rol krejt të ri, dhe të përshtatshëm për të gjitha grupet e fëmijëve.

Secili fëmijë, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, ka synimet e tij, interesat, aftësitë e ndryshme, funksionin e trurit të ndryshëm, vijnë nga familje përkatësisht prindër të ndryshëm, rrethe të ndryshme si dhe mundësitë për të nxënë i kanë të ndryshme.

Pikërisht marrja parasysh e këtyre dallimeve që kanë fëmijët, e që reflektojnë edhe në të nxënit e tyre, e imponon punën individuale krahas formave të tjera të punës.

Për ta jetësuar këtë synim (përafrimin e dallimeve që kanë fëmijët në procesin e të nxënit, përfshirë fëmijët me NV), duhet të arrijmë të unifikojmë qëndrimet dhe pikëpamjet e të gjithë faktorëve edukativë, (prindërve, mësimeve, rrethit) për të siguruar qasje të suksesshme edhe për fëmijët me nevoja të veçanta. Procesi i gjithëpërfshirjes është i lidhur ngushtë me ndryshimet dhe përshtatjet në përmbajtjet e programeve mësimore, në qasjet pedagogjike, në strukturat dhe në strategjitë me qëllim të plotësimit të nevojave specifike në të mësuar të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Nga një studim i autorëve (Gerber & Popp, 1999), del se prindërit, si rezultat i bashkëpunimit të mirë me mësuesit vërejnë impakte shumë pozitive tek fëmijët e tyre, që janë të përfshirë në shkollat e zakonshme. Ata vërejnë përmirësime në drejtim të kënaqësisë, besimit dhe të aftësive të fëmijëve të tyre në të mësuar. Kur prindërit shihen si aleatë, partnerë në punën me nxënësit me nevoja të veçanta, rriten shanset që gjithëpërfshirja për këta nxënës të ketë rezultat.

Zbatimin e gjithëpërfshirjes, e bëjnë të domosdoshme edhe dokumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut-fëmijëve, në veçanti. Deklarata e Salamankës që përcakton qartë se “Fëmijët me nevoja të veçanta duhet të kenë akses në shkolla të zakonshme, dhe ato duhet t’u sigurojnë akomodim të përshtatshëm, me qëllim të plotësimit të nevojave dhe ofrimit të qasjeve pedagogjike me në qendër nxënësin (The Salamanca Statement, 1994)

Poashtu edhe në përcaktimin e UNESCO-s (UNESCO, 2003) arsimit gjithëpërfshirës është përcaktuar si një proces që adreson dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të të gjithë nxënësve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në të mësuar.

Në kuptimin edhe më përmbajtësor, edukimi gjithëpërfshirës nënkupton jo vetëm përfshirjen pasive, por edhe:

- *Shtim të pjesëmarrjes së nxënësve në kurrikul, në shkollë, në komunitet;*
- *Vlerësim të të gjithë nxënësve pa dallim;*

- *Zbutje të barrierave në procesin e të nxënësve dhe sigurim të pjesëmarrjes së të gjithë nxënësve;*
- *Sigurim të mundësisë së nxënësve që të arsimohet në vendbanimin e tij;*
- *Inkurajim të marrëdhënieve reciproke dhe të qëndrueshme midis shkollës dhe komunitetit.*

Qasja e bazuar në të drejtat në arsim, në veçanti në kontest të jetësimit të gjithëpërfshirjes është ndërtuar mbi tri parime:

- *Qasje në arsimin falas dhe të detyrueshëm për të gjithë fëmijët pa dallim;*
- *Barazi, gjithëpërfshirje dhe jo diskriminim;*
- *E drejta për arsimim cilësor, përmbajtje dhe procese.*

Përvoja e shekullit të kaluar i dha një mësim të çmuar shoqërisë sonë, ndarja e një pjese të nxënësve në shkolla të veçanta kishte efekte negative në jetën e tyre të mëtejme, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë realitet, por e shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë sfidë po ballafaqohet edhe vendi ynë, i cili po bënë përpjekje për realizimin e konceptit gjithëpërfshirës. Ky proces nuk mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër, pasi ka si synim ndryshime të vazhdueshme në sistemin arsimor, të shkollës, por edhe të vetë mësuesit për ta bërë atë më fleksibël, më të përshtatshëm për t'iu përgjigjur nevojave dhe diversitetit të nxënësve. Për fëmijët me nevoja të veçanta, shkolla duhet të jetë një vend ku fëmija pa marrë parasysh llojin e paaftësisë së tij, ka mundësi të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar, e të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor.

1.1. Llojet e aftësive të kufizuara të fëmijëve me nevoja të veçanta (FNV) dhe strategjitë e mësimdhënies

Vlerësohet se 1 në 10 fëmijë lind apo pëson gjatë jetës një dëmtim serioz (Blandul, 2010), për të cilin, nëse nuk bëhet kujdes janë të gjitha gjasat që zhvillimi i tij të pengohet, pa marrë parasysh këtu që numri rritet nëse marrim në konsideratë edhe faktorë të tjerë që veprojnë gjatë jetës, pra rezulton se 20% e nxënësve gjatë periudhës së shkollimit paraqesin diku më pak, e diku më shumë nevoja të veçanta.

Aftësitë e kufizuara tek fëmijët mund të klasifikohen:	Strategjitë e mësimdhënies me grupet e fëmijëve me nevoja të veçanta
<p><u>Ngecjet në zhvillimit mendor</u></p> <p>Prapambetja mendore është problem kompleks, shumëdimensional, prandaj ekzistojnë përkufizime të shumëllojshme si (medicinale, psikologjike e pedagogjike) Sipas Asociacionit Amerikan për retardim mental" Prapambetja mendore paraqet funksionin intelektual bukur shume nën nivelin mesatar që manifestohet në periudhën e zhvillimit dhe për të cilin është karakteristikë papërshtatshmëria e sjelljes adaptuese.</p>	<p>-Demonstroji fëmijëve se çfarë dëshiron të bëjë ai ose ajo, se sa vetëm të ju tregosh me fjalë.</p> <p>-Përdorë fjalë të thjeshta dhe kontrollo nëse fëmija ka kuptuar.</p> <p>-Përdorë objekte reale që fëmijë mund ti ndjejë, dhe ndërlidhë mësimet me përvojat e fëmijës.</p> <p>-Bëje një aktivitet në kohë dhe përfundoje.</p> <p>-Jepni lëvdata dhe inkurajoni fëmijët</p> <p>-Jepni fëmijës ushtrime shtesë për të bërë detyrën, me qëllim të rritjes së vetbesimit.</p> <p>-Vendosë fëmijën me shokun i cili mund ti ndihmojë në asistimin në aktivitetet në klasë.</p> <p>-Injoro sjelljen e padëshirueshme.</p>
<p><u>Dëmtimet në të parë</u></p> <p>Sipas përkufizimit pedagogjik, "I verbët është ai fëmijë i cili e ka aq të dëmtuar të pamurit, saqë nuk është në gjendje të arsimohet në mënyrë vizuale. Ai në procesin e arsimimit shfrytëzon shqisat e të prekurit, të dëgjimit, alfabetin e Brrajllit(Braille) dhe aparate speciale që i mundësojnë arsimim të suksesshëm". Ndërsa, me të pamurit e dobtë është ai fëmijë i cili mund të arsimohet në mënyrë vizuale dhe nuk ka nevojë të mësojë alfabetin e Brrajllit.</p>	<p>-Shkruaj me shkronja të mëdha në tabelë, përdorë shkumësa me ngjyra dhe lexo atë që shkruan në tabelë.</p> <p>-Përdorë mjete ndihmëse siç janë materialet e mëdha të printuara.</p> <p>-Inkurajoje fëmijën që të përdorë tregues ose të përdorë gishtin kur lexon, dhe mbulo pjesën tjetër të faqës me letër.</p> <p>-Përdorë më shumë shpjegimin.</p> <p>-Përdorë lëvdata gojore me fëmijët.</p> <p>-Thuaji emrat e nxënësve gjatë diskutimeve, me qëllim që fëmija me dëmtimë në të aprë të dij kush po flet.</p> <p>-Përdorë kompjuterin, sepse jep mundësi për zmadhim të materialeve, si dhe mundësi auditive.</p>

<p><u>Dëmtimet në të dëgjuar</u></p> <p>Sipas përkufizimit operativ të shurdhër konsiderohen "personat te të cilët të dëgjuarit nuk është funksional në jetën e përditshme, ndërsa gjysëm të shurdhër janë ata që kanë të dëmtuar shqisën e dëgjimit , por që të dëgjuarit e tyre është funksional në jetën e përditshme falë aparatave ndihmëse të dëgjimit ose pa to"</p>	<p>-Sigurohu që fëmija i shurdhër të merrë kopje të shkruar të mësimëve.</p> <p>-Provo të ofrosh libra e materiale të shkruara sa më shpesh që është e mundur.</p> <p>-Përdorë më shumë mjete vizuale, ilustrime, fotografi, grafikë etj.</p> <p>-Bëjë rezyme mësimi sipas nevojës së fëmijëve me dëmtime në dëgjim</p> <p>-Paraqite leximin meqë kjo ofron mediumin më të rëndësishëm për të mësuar fëmijën dhe për të komunikuar me të tjerët.</p>
<p><u>Vështirësitë në komunikim</u></p> <p>Të folurit përcaktohet si defektiv, në rast kur dallon nga të folurit e njerëzve të tjerë, ose interferonë në komunikim me bashkëbiseduesit.</p>	<p>-Mos ndërhy dhe mos lejo të ndërhyjnë të tjerët, derisa është duke folur fëmija me vështirësi në komunikim.</p> <p>-Bëjë përsëritje, fjalëve që shqiptohen me problem.</p> <p>-Të flitet gjuhë e qartë dhe sa më e kuptueshme për ta.</p> <p>-Të ju ofrohen lodra, ku vihet në përdorim goja (fryerja e balonave, imitimi i situatave etj)</p> <p>-Zgjedhë përmbajtje mësimore, ku fokusohen rregullat gramatikore.</p> <p>-Kërko të formulojnë pyetje dhe të japin përgjigje logjike për to.</p>
<p><u>Vështirësitë emocionale dhe në sjellje</u></p> <p>Vështirësitë emocionale karakterizohen me tërheqje mbyllje në vete të fëmijëve, si dhe me disponim jo të mirë, ndërsa vështirësitë në sjellje definojnë si shkallëzim në masë të tepruar i sjelljes së qëndrueshme dhe të përsëritur e që manifestohet</p>	<p>-Injoro sjelljen e papërshtatshme.</p> <p>-Mos u përqendrohu në sjelljen e papërshtatshme, por në të kuptuarit e qëllimit të tij, të asaj që e shtyen për të manifestuar at sjellje.</p> <p>-Bashkëpunohet në mënyrë sistematike me prindërit, për të kuptuar shkaktarët e sjelljeve të tilla.</p> <p>-Kërko ndihmën e profesionistëve nëse nuk mund të gjesh vet zgjidhje.</p>

shpeshherë me veprime agresive ndaj personave të tjerë.	-Përdorë edhe teknikat si: vështirimi me vëmendje i tërë klasës, bërja e pyetjeve me qëllim, lëvizjet nëpër tërë klasën, ndryshimi i fizionomisë.
---	---

1.2. UDHËZIME PËR MËSIMDHËNËSIT

Për të zbatuar suksesshëm strategjitë e mësimdhënies në punën individuale me fëmijët me nevoja të veçanta, është i rëndësishëm edhe mjedisi në të cilin do të zhvillohet mësimi, përkatësisht rregullimi i tij sipas karakteristikave dhe nevojave të fëmijëve si dhe elemente tjera.

Është e dobishme të planifikohet funksionimi i përgjithshëm, në mënyrë më efektive, sepse përgatitjet e bëra përpara mësimdhënies do të rrisin efektivitetin e mësimdhënies.

- Mësimdhënësi të arrijë të njohë karakteristikat dhe stilin e të nxënësve të fëmijëve, sepse mësimdhënja efektive është e lidhur ngushtë me njohjen e karakteristikave të nxënësve;
- Të reduktohen sjelljet negative që mund të shihen te nxënësve, dhe të përdoret koha në mënyrë efektive.
- Numri i nxënësve në klasë, nuk duhet të jetë më i madh se numri i nxënësve me të cilët mund të merret mësimdhënja.
- Duhet të përshtaten materialet që do të përdoren në mësimdhënje, në veçanti për fëmijët me nevoja të veçanta, përmbajtja e lëndës, dhe detyrat që do t'u jepen nxënësve.
- Në klasë mund të caktohet një vend i veçantë për mjetet speciale (paterica, etj.) që përdoren nga individë me nevoja të veçanta.
- Mësimdhënësi, duhet të ketë informacion të detajuar në lidhje me karakteristikat njohëse, fizike, sociale dhe emocionale të nxënësve me nevoja të veçanta, dhe mbi bazën e tyre përdorë materialet e nevojshme.
- Rëndësi të veçantë ka edhe dhënja e udhëzimeve gjatë mësimin. Kur nxënësi nuk e kupton udhëzimin e dhënë, do të jetë e vështirë të përmbushë atë që kërkohet. Për këtë arsye duhet pasur kujdes që gjatë dhënies së tyre, të njëjtat të jenë të shkurtra dhe të qarta, të jepen një nga një, dhe të përsëriten sipas nevojës.
- Materialet e përzgjedhura për mësimdhënje duhet të jenë të përshtatshme për nivelin e zhvillimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Mësimdhënja duhet të mbështetet në sa më shumë materiale, dhe nxënësi duhet të lejohet të përdorë materialin.

- Mësimdhënia në grupe të mëdha bën që studentët me nevoja të veçanta të humbasin motivimin për të mësuar, të ndikojnë negativisht në performancën e tyre dhe shfaqin sjellje problematike. Për këtë arsye, është e nevojshme të përfshihet mësimi në grupe të vogla dhe punë individuale.

Programet mësimore duhet të jenë dizajnuara në atë mënyrë që të bëjnë të mundur;

- Përqendrimin e nxënësve, përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta;
- Heqja e barrierave për të mësuar (duke siguruar që edhe nxënësit me nevoja të veçanta të kenë akses në mësim)
- Përgatitja e një programi fleksibël që plotëson nevojat e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Socializimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Pranimin e diversitetit;
- Zhvillimin e tolerancës;
- Pranimin e ndihmës nga të tjerët;
- Forcimin e personalitetit të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në punën me fëmijë, e në veçanti me fëmijët me nevoja të veçanta duhet respektuar edhe parimet e dhëna në vazhdim:

- Përqendrimi te nxënësi, me qëllim të vendosjes së tij në qendër të vëmendjes.
- Në vend të përdorimit të përmbajtjeve fikse, duhet të paraqiten përmbajtje, detyra e aktivitetete që marrin parasysh interesat dhe nevojat e e nxënësve me nevoja të veçanta.

1.3. ZBATIMI I FORMËS INDIVIDUALE E PUNËS MËSIMORE

Zbatimi i kësaj forme paraqet një nga kërkesat primare të organizimit bashkëkohor të punës mësimore, e në veçanti sot në kohën e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta.

Kjo formë e organizimit të punës mësimore në mënyrë të veçantë, e aktualizuar në rrethanat e tashme të organizimit të veprimtarisë arsimore nga aspekti i zhvillimit, themi se ka mbërritur shkallën më të lartë të përsosjes.

- *Në literaturën bashkëkohore pedagogjike ndër shkaqet kryesore për zbatimin e kësaj forme të organizimit të punës mësimore paraqiten kryesisht këta faktorë:*

- Mosha e diferencuar kronologjike e nxënësve;
- Ndryshimet në shkallën arsimore dhe të paranjohurve të nxënësve;
- Ndryshimet në aftësitë psikike dhe individuale të nxënësve; dhe
- Faktori i mjedisit shoqëror dhe familjar i nxënësve prej nga ata vijnë.

Këta elementë të cekur më lart, flasin bindshëm për ekzistimin e karakterit heterogjen, të strukturës së nxënësve në kuadër të një klase, dhe shtron kërkesën për një fleksibilitet të nevojshëm si në organizimin, ashtu edhe në realizimin e punës mësimore, duke bërë që individualizimi në punën mësimore të jetë pjesë e pandarë e tërë procesit të organizimit të shumëfishtë të punës mësimore. Në këtë formë të punës mësimore, mësimitdhënësi punon drejtpërdrejt me një nxënës, sidomos kur ky ka nevojë për udhëheqje dhe për ndihmë në të nxënë njohuri, për të zhvilluar shkathtësi dhe për të formuar shprehje të caktuara. Në këtë formë të organizimit të punës mësimore, mësimitdhënësi përmes parashtrimit konciz, shpjegimit, përshkrimit, sqarimit dhe veprimit konkret praktik motivon nxënësin të përvetësojë njohuri, të nxjerrë dhe zbatojë në praktikë përgjithësimet e caktuara, duke e zbatuar teknikën dhe teknologjinë mësimore të përshtatshme. Në këtë formë të mësimitdhënies komunikimi është dy kahësh, sepse si mësimitdhënësi ashtu edhe nxënësi mund të marrin dhe të japin informacionin e kërkuar për zhvillimin e procesit të mësimitdhënies. Andaj kjo formë e organizimit garanton efikasitet të lartë të punës mësimore, në veçanti me fëmijët me nevoja të veçanta. Në këtë formë të punës nxënësi ka pavarësi të madhe në procesin e përvetësimit të njohurive, zhvillimit të shkathtësive dhe formimit të shprehjeve të caktuara.

Ndërlidhja e formës individuale të organizimit të punës mësimore me format e tjera të punës, sidomos me mësimin ballorë dhe me formën e punës në grupe, bënë të mundur socializimin e nxënësve përmes komunikimit shumëkahësh social, dhe racionalizon e ekonomizon punën mësimore.

1.4. PLANI INDIVIDUAL I ARSIMIT

Qëllimet e planprogrameve individuale janë shumë, por qëllimi gjatë parashkollorit, shkollës fillore, të mesme të ulët, e të mesme të lart është që, çdo nxënës me paaftësi, të ketë mundësi për të pasur eksperiencë të suksesshme në shkollë, e cila do t'i çojë drejt një karriere ose edukimit të mëtejshëm. Qëllimet finale për këta individë janë të jenë të pranishëm në komunitet, të kenë një pjesëmarrje të vërtetë në shoqëri, punë të mira dhe një jetë të lumtur. Këto rezultate të shkëlqyera janë një produkt i edukimit të përshtatshëm, i ofruar me sa më pak kufizime që të jetë e mundur,

nga mësues tejet efektivë që përdorin praktikat e bazuara në kërkim, dhe marrin vendime të bazuara drejtpërdrejt në performancën e nxënësve në klasë. Plani Individual i Arsimit (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues komunal apo edhe ekipi në nivel institucioni ka marrë vendim për arsim me nevoja të veçanta arsimore. Plani Individual i Arsimit shërben për planifikimin sistematik të nxënies, mësimdhënies, për mbështetjen dhe ndjekjen e përparimit individual të fëmijës. Plani individual i arsimit duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindërit, fëmijët (kur është e përshtatshme) dhe personelin tjetër përkatës. PIA është një dokument i besueshëm (konfidencial) dhe informatat për të mund t'u japin të tjerëve vetëm me lejen e prindërve. Ai i referohet përshtatjes së kurrikulës dhe fokusohet në nevojat me prioritet të nxënësit.

PIA përcakton:

- » Qëllimet edukative, arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat plani individual
- » Rezultatet e nxënies të fëmijës, përmes të cilave realizohet qëllimi i synuar
- » Metodatat dhe format e punës, të nevojshme për të realizuar rezultatet e nxënies
- » Burimet e nevojshme për shërbimet që duhet ofruar si dhe burimet ekzistuese
- » Përmbytjen e individualizuar të lëndëve mësimore ose të fushave të aktiviteteve
- » Format e vlerësimit të fëmijës
- » Personat përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e PIA-s
- » Procesin e monitorimit dhe të rishikimit të tij.

Cilësia e procesit për zhvillimin e Planit Individual të Arsimit në një mënyrë përcakton cilësinë dhe efektivitetin e planit. Prandaj koordinimi i mirë i punës, bashkëpunimi dhe ndarja e përgjegjësisë midis akterëve të ndryshëm është thelbësore për gatëjen e hartimit të këtij plani.

Plani Individual Arsimor përbëhet nga:

- Pjesa Administrative - qëllimi i së cilës është mbledhja e të dhënave kryesore të fëmijës, për të cilat paraprakisht kërkohet pajtimi i prindit ose kujdestarit të tij.

- Pjesa Pedagogjike - është pjesa më e rëndësishme e PIA-s. Përfshinë informatat për gjendjen aktuale të fëmijës, aftësitë, shkathtësitë, prirjet dhe nevojat. Duhet përshkruar qartë qëllimet dhe rezultatet e të nxënit, metodat e punës, përshtatjet, materialet e nevojshme didaktike dhe mënyrat e vlerësimit të fëmijës.
- Pjesa Rehabilituese - Përveç pjesës pedagogjike, disa fëmijë kanë nevojë edhe për trajtime reha- bilituese, të cilat kryesisht ofrohen jashtë institucioneve edukativo-arsimore. Përveç qendrave burimore, të cilat mund të ofrojnë disa shërbime, shërbimet e tjera janë në domenin e institucioneve shëndetësore. Kjo pjesë duhet të plotësohet vetëm në rastet kur fëmija merr shërbimet rehabilituese.

I. PJESA ADMINISTRATIVE

Të dhënat për fëmijën

Emri dhe Mbiemri	
Ditëlindja	
Prindërit / Kujdestarët	
Gjuha amtare	
Telefoni	
Adresa e postës elektronike	
Vendbanimi	
Institucioni arsimor	
Klasa/ Grupmosha	
Mësimdhënësi/Edukatori	

1. Historiku i shkollimit paraprak

<input type="checkbox"/> Çerdhe	Periudha kohore _____
<input type="checkbox"/> Kopsht	Periudha kohore _____

<input type="checkbox"/> Shkollë	Periudha kohore _____
<input type="checkbox"/> Qendra burimore	Periudha kohore _____
<input type="checkbox"/> Të tjera	

2. Gjendja shëndetësore e fëmijës/nxënësit

Rekomandimet mjekësore	
Intervenimet	
Rehabilitimet	
Terapitë mjekësore	
Pajisjet mbështetëse	
Shërbimet e tjera	

II. PJESA PEDAGOGJIKE

1. Niveli i gjendjes aktuale të fëmijës

Nëse

fëmija/nxënësi ka vlerësim pedagogjik nga ekipi vlerësues komunal, përshkruajeni në këtë pjesë) Data: _____

1. Fusha njohëse dhe njohuritë e përgjithëse

--

2. Fusha sociale dhe emocionale

--

3. Fusha e gjuhës dhe komunikimit

--

4. Fusha e zhvillimit fizik

--

5. Fusha e shkathtësive të jetës së përditshme

--

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I TË NXËNIT

Qëllimi është pikësypnim të cilin dëshirojmë të arrijmë si rezultat i punës pedagogjike me fëmijën/nxënësin brenda një periudhe të caktuar kohore (një vitë shkollor)

QËLLIMI 1.

QËLLIMI 2.

2. Lënda e individualizuar _____		
Data _____		
Numri i orëve të përcaktuara _____ Emri i mësimitdhënësit _____		
Aftësitë dhe shkathtësitë enxënësit për lëndë	Nevojat arsimore të nxënësit për lëndë	
Rezultatet e të nxënit		
Metodat dhe teknikat e punës <input type="checkbox"/> Verbale <input type="checkbox"/> Ilustrimit <input type="checkbox"/> Demonstrimit <input type="checkbox"/> Eksperimentale	Format e punës <input type="checkbox"/> Individuale <input type="checkbox"/> Çift <input type="checkbox"/> Grup	Materialet didaktike

<input type="checkbox"/> Laboratorike <input type="checkbox"/> (shto të tjera)		
<p>Mbështetja nga bashkëpunëtorët profesionalë brenda dhe jashtë</p> <input type="checkbox"/> Edukatori mbështetës <input type="checkbox"/> Mësuesi udhëtues nga qendrat burimore <input type="checkbox"/> Psikologu <input type="checkbox"/> Pedagogu <input type="checkbox"/> Punëtori shëndetësor (pediatri, infermierja etj.) Etj. (shto të tjerë)		
<p>Metodat e vlerësimit të të nxënit të fëmijës/ nxënësit</p> <input type="checkbox"/> Testet e administruara individualisht ose për grupe të vogla <input type="checkbox"/> Lejimi i kohës shtesë për nxënësin për të plotësuar testet apo detyrat <input type="checkbox"/> Lejimi i përgjigjeve me gojë <input type="checkbox"/> Thjeshtësimi i gjuhës së përdorur dhe udhëzimeve për pyetjet në teste <input type="checkbox"/> Përdorimi i fotografive dhe simboleve <input type="checkbox"/> Përdorimi i mjeteve konkrete gjatë vlerësimit <input type="checkbox"/> Inkurajimin e vetëvlerësimit të nxënësve <input type="checkbox"/> Vlerësimi me anë të projekteve individuale ose grupore <input type="checkbox"/> Vlerësimi me anë të portfolios etj. <input type="checkbox"/> (shto metoda/instrumente të tjera të përdorura etj.)		

III. Pjesa rehabilituese

(Kjo pjesë plotësohet në rastet kur fëmija merr shërbime rehabilituese)

1. Shërbimet rehabilituese

Lloji i shërbimit	Institucioni/shoqata/OJ Q/Personi privat që ofron shërbime	Periodha kohore

2. Vlerësimi dhe shkëmbimi i informatave nga ofruesit e shërbimeve rehabilituese

(Bashkëngjitni raportin nga shërbimet rehabilituese ose përshkruani disa prej shërbimeve që i bëhen fëmijës)

RISHIKIMI

- Puna individuale me fëmijët me nevoja të veçanta

Gjithëpërshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione të rregullta edukativo arsimore, përveç ndryshimeve të domosdoshme në infrastrukturën shkollore, ka imponuar edhe ndryshime në organizimin e brendshëm të procesit të mësimdhënies, me qëllim që të gjithë fëmijëve, përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta t’iu sigurohet arsim cilësor, pavarësisht dallimeve në zhvillimin individual. Të tilla ndryshime të brendshme kanë përfshirë:

- Rregullimin dhe përshtatjen e mjediseve të nxënies për të gjitha grupet e fëmijëve, në veçanti për fëmijët me nevoja të veçanta
- Rritjen e stafit të shërbimeve të konsulencës në shkolla
- Rishikimin e kurrikulës
- Ndryshimin e qasjes në procesin e mësimdhënies, duke synuar vendosjen e nxëniesit në qendër të vëmendjes, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta

- e) Zbatimin e llojlojshmërisë së strategjive, metodave, teknikave e formave të punës, me qëllim të lehtësimit të të nxënitorit të gjithë fëmijët
- f) Ndryshimet në planifikimin e punës mësimore, si dhe
- g) Zbatimin e Planit Individual Arsimor, me qëllim të rritjes së mundësive për të nxënë cilësor të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Literatura

Guidelines on the individual education plan process, published by the Stationery Office, Dublin, May 2006

The individual Education Plan (IEP), A resource Guide, Ministry of Education, Ontario, 2004

Individual Education Plan – IEP as a produkt. Lectures of Elina Oksanen 10/2009

Teaching organized according to activity areas. Finnish National Board of Education 2010

Raçi. A, Gashi. Sh, (2001). Doracak pune i përgatitjes me shkrim për orën mësimore, Prishtinë

Muka. P, Karaj. Dh, & Qela. L, (2002). Hyrje në mësimdhënien e diferencuar, Tiranë

Tomlinson. C, A, (2001). How to differentiate instruction in mixed-ability classrooms (2nd edition) Alexandria

Tomlinson. C, A, (2003). Fulfilling the promise of the differentiated classrooms, ASCD, Virginia USA

<http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/>

http://www.edu.fi/erityinen_tuki/avauksia_opsiin/opetuk-sen_jarjestaminen_toiminta-alueittain